



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1821/7 prot.

Tiranë më 27. 12. 2023

VENDIM

Nr. 73, datë 27.12.2023

PËR KONTROLLUESIN “MONTESSORI TIRANA” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Montessori Tirana” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 186, datë 13.11.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, me fokus të veçantë publikimin/informimin/marketingun dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L71913034E, dhe ka si objekt veprimtarie edukimin e fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “fëmijë”, “punonjës aktual”, “punonjës të larguar”, “aplikantë për punë”, “prindër/kujdestarë ligjorë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për stafin akademik dhe fëmijë në arkivën fizike, si dhe pranë ambienteve të “ProActive Solution” SHPK, i cili ofron shërbime konsulence për Kontrolluesin. Konstatohet se në arkivën fizike ruhen CV të subjekteve të të dhënave “kandidatë për punë”, të cilët kanë aplikuar për pozicione të lira pune por që nuk janë punësuar nga Kontrolluesi.

Këto të dhëna ruhen nga Kontrolluesi, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 42, datë 22.07.2014 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara nga Kontrolluesi në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, si “CV të kandidatëve për punë”, duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi, disponon llogari në rrjetet sociale “facebook” dhe “instagram” dhe publikon fotografi/video të fëmijëve, të mësuesve të kopshtit/çerdhes, si dhe të prindërve, duke pasqyruar aktivitetet që zhvillon.

Kontrolluesi, nëpërmjet sms në “Whatsapp” merr pëlqimin nga prindërit nëse mund të publikoj fotografi të fëmijës, por konstatohet se nuk informon në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi aplikon një formular online, të cilën ua dërgon prindërve që kanë rënë dakord për të regjistruar fëmijën në çerdhe/kopësht.

Ky formular përmban “emër, mbiemër dhe fotografi” të fëmijës, si dhe “emër, mbiemër dhe fotografi” të prindërve apo kujdestarit ligjor. Pasi plotësohet formulari bëhet “submit” dhe pas kësaj prindi duhet të pranoj rubrikën “accept the terms and conditions and submit again”.

Nga analizimi i rubrikës “*terms and conditions*” rezulton se, informimi nga Kontrolluesi për subjektet e të dhënave nuk është shterues, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Konstatohet se Kontrolluesi nuk kishte realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave në hyrje të ambienteve, ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Gjithashtu, nga analizimi i pozicionit të kamerave u konstatua se, një prej kamerave është e pozicionuar nga rruga kryesore dhe ka pamje të kalimtarëve në rrugë dhe ndërtesave përballë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe të germës “*a/i*”, pika 5, e Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Kontrolluesi vendosi tabelën e informimit për CCTV, në datë 23.11.2023, pas fillimit të hetimit administrativ.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si “*imazhe*” dhe “*video*”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi nuk ka “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Kontrolluesi nuk ka hartuar Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Procesverbali u dërgua në rrugë postare në datën 07.12.2023, së bashku me shkresën për njoftimin e seancës dëgjimore, e cila ishte planifikuar për t'u zhvilluar në datë 13.12.2023, ora 11:30. Në datën 13.12.2023, Kontrolluesi nuk mori pjesë në seancë dëgjimore. Në datën 18.12.2023, zarfi i dërguar me procesverbalin dhe shkresën e seancës dëgjimore kthehet nga posta pa asnjë shënim.

Ndërkohë, më datë 18.12.2023, grupi i inspektimit, ka dërguar me e-mail në adresën info@montessoritirana.al (*adresë e Kontrolluesit me të cilën është komunikuar gjatë zhvillimit të hetimit administrativ*) procesverbalin si dhe shkresën e seancës dëgjimore (*e cila do të zhvillohet datë 22.12.2023, ora 11:00, duke marr parasysh që Kontrolluesi nuk ishte njoftuar*). Ky email u kthye me arsyen “*Diagnostic-Code: This mail has been blocked because the sender is unauthenticated. Gmail requires all senders to authenticate with either SPF or DKIM*”.

Në datë 20.12.2023, për shkak të rrethanave të sipërcituara grupi i inspektimit, vendosi që të dorëzojë dorazi pranë Kontrolluesit, procesverbalin dhe shkresën e seancës dëgjimore.

Po në datën 20.12.2023, pranë zyrës së protokollit, të Zyrës së Komisionerit, përfaqësuesi i Kontrolluesit ka dorëzuar pretendimet me shkrim, të cilat u administruan me nr. 1821/6 prot., datë 20.12.2023. Gjithashtu, përfaqësuesi i Kontrolluesit mori në dorëzim procesverbalin së bashku me njoftimin e seancës dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore (*zhvilluar në datë 22.12.2023*), përfaqësuesit e Kontrolluesit kanë bërë me dije se njoftimin për seancë dëgjimore së bashku me konstatimet e procesverbalit i kanë marrë nëpërmjet email-it të datës 18.12.2023.

Gjithashtu, përfaqësuesit e Kontrolluesit deklarojnë se i qëndrojnë pretendimeve me shkrim që kanë depozitur dhe se janë marrë masa për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara në hetimin administrativ.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur pretendimeve konstatohet se, në Formularin e “*Njoftimit*”, ka mangësi në deklarin për disa rubrika, si psh: kategoritë e subjekteve të të dhënave, kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, marrësit e të dhënave, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimi i vazhdueshëm i gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore.

Nga shqyrtimin i Rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, konstatohet se, është modeli “*tip*” që gjendet në faqen zyrtare të

Komisionerit dhe nuk parashikon proceset, procedurat, masat tekniko-organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., lidhur me veprimtarinë e Kontrolluesit, në kundërshtim kjo me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*për çdo kategori subjekti të dhënash*), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, geramat “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenin 5 dhe 6 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi të ketë në vëmendje përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 8- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
- 9- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të ketë në vëmendje detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, lidhur me trajnimin e vazhdueshëm të stafit të tij;
- 10- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 5, 6 dhe 9 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 7 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 8 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

- 11-** Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 12-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 13-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 27.12.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi